



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legj. -III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 15**

nga mbledhja e mbajtur më **24.6.2008**

kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit

Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Hestet Cakolli , Kosara Nikolić, Elheme Hetemi, Zef Morina, Zylfi Merxha, Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina..

Mungoi :

Selvie Halimi dhe Ibrahim Selmanaj

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri, Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : Përfaqësuesi i MBPZHR , Shefki Zeqiri
Përfaqësuesi i OSCE Blerim Vela
Përfaqësuesi i presidencës Nexhat Shatri

RENDI I DITËS :

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve,**
- 3. Shqyrtimi i shkresës nga Ombudspersoni i Kosovës rreth pushimores së Prevallës.**

1. Procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi Lulzim Zeneli hapi mbledhjen dhe u konstatua i miratuar procesverbali nga mbledhja e kaluar me këto vërejte:

Kosara Nikoliq tha se nuk është konstatuar diskutimi i saj në procesverbal.

Berat Luzha theksoi se gjatë diskutimit të tij ka thënë se përgjegjëse është Ministria (MMPH) e jo ashtu si është në proces.

2. Shqyrtimi i Projektligjit të produkteve për Mbrojtjen e Bimëve

Lulzim Zeneli - kryetar i komisionit, theksoi se për Projektligjin e produkteve për Mbrojtjen e Bimëve fjalën do ta marrë raportuesja Elheme Hetemi.

Elheme Hetemi – ajo propozimet e bëra në Projektligjin e produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, i prezantoi para komisionit me këto amendamente:

Amendamenti 1

Për arsye të hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës Preambula duhet të riformulohet si vijon:

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65.1 dhe nenit 80.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,....

Amendamenti 2

Titulli i projektligjit të përdorët njëjtë (të unifikohet)në tërë tekstin e projektligjit:

Ligji i produkteve për Mbrojtjen e bimëve.

Komisioni unanimisht i miratoje Amendamentin 1 dhe 2.

Komisioni nuk e miratoi **Amendamentin 3**, sepse në përkufizime është definuar se fjala ministri ka të bëjë me ministrinë e bujqësisë.

Komisioni diskutoi rreth fjalive ‘mund’ dhe ‘duhet’. Gjithashtu fjalën e morri Shefki Zeqiri, ai theksoi se për arsye të terminologjisë së shkruar, fjalët ‘mund’ dhe ‘duhet’ duhet të mbesin si ne ligj.

Pas diskutimit të gjithanshëm amendamentin 4, u miratua pjesërisht.

Lulzim Zeneli , ai propozoi të procedohet nen për nen për Projektligjin e produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

Komisioni propozoi që Preambula të harmonizohet sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Komisioni propozoi që neni 3 (1) fjalia ‘ Nuk mund të vendoset në treg’ të zëvendësohet me fjalinë ‘Nuk lejohet nxjerrja në treg’, Dhe u debatua për paragrafin (3) fjalia ‘Nuk është i nevojshëm autorizimi’.

Rreth këtyre propozimeve u paraqitën paqartësi kështu që komisioni kërkoi që zyrtarët ligjore të Ministrisë të bëjnë riformulimin e nenit 3.

Komisioni kërkoi nga Ministria të jap sqarime për nenit 23(2).

Në nenin 27 (1), fjalia e fundit ‘Në raste të tilla.... të plotësohet.

Komisioni kërkoi nga Ministria të ofrojë direktivën 91/414 EEC për rishikim.

Njëkohësisht të ofrojë sqarime rreth neni 55 (2), se a duhet të figurojë ky paragrafë, si dhe treguesi duhet të dallohet nga përdoruesi.

3. Shqyrtimi i shkresës nga Ombudspersoni i Kosovës rreth pushimores së Prevallës

Në pikën e tretë diskutuan: **Lulzim Zeneli, Elheme Hetemi, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Heset Cakolli , Kosara Nikolić, Zef Morina, Ali Lajçi dhe Zylfi Merxha.**

Pas diskutimit të gjithanshëm u theksua se janë shkelë ligjet: Ligji për mbrojtjen e Natyrës, Ligji mbi Planifikimin Hapësinorë dhe Ligji për Parkun Nacional ‘Malet e

Sharit', ndaj edhe është krijuar baza juridike për këtë komision që të kërkoji veprim nga Qeveria.

Komisioni gjatë diskutimeve paraqiti pakënaqësi rreth këtyre çështjeve:

- Ndërprerja e prerjeve ilegale të pyjeve,
- Ndërprerja e aktiviteteve ndërtimore në zonën e Parkut Nacional në Prevallë, dhe
- Ndërprerja e punës së gurëthyesve.

Dhe nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Komisioni për shkresën nga Ombudspersoni i Kosoves rreth pushimores së Prevallës, në takimin e radhës do të propozoi Rekomandime për Kryesin e Kuvendit (Seancën Plenare) dhe njëkohësisht këtë çështje Kryesia ta radhitë në Seancën e parë të radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 15,30.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli